



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 117/1 prot.

Shkodër, më 9.2.2023

**Lënda:** Mbi vendimin Nr.5, datë 25.01.2023 të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU-DEJËS**

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8 germa a, neni 16, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, ligjit Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” ndryshuar, neni 9 pika 1.2, germa a, neni 27 pika 5, neni 54/e/1, neni 55/3, neni 64 germa c, shqyrtoi **VKB Vau-Dejës Nr.5, datë 25.01.2023** “Mbi miratimin në parim të listës së pasurive të llojit “Kullotë” të gatshme për dhënie në përdorim” sipas dokumentacionit të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Vau-Dejës me shkresën Nr.491prot datë 30.01.2023.


Pas analizimit konstatohet si vijon:

Me anë të këtij vendimi në të njëjtën datë mbledhje të Këshillit Bashkiak keni miratuar një listë tjetër të kullotave, ndërkohe që me **VKB nr.4, datë 25.01.2023**, është miratuar një listë e kullotave të gatshme për kositje/kullotje bari sipas VKM Nr.686 datë.2.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 8.06.2016 të këshillit të ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike”, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish/komunave /bashkive të ndryshuar” dhe Kreut II, pika 2 e Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.2, datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”. Pyetja që lind përse nuk janë pjesë e së njëjtës Vendim të Këshillit Bashkiak?

Ju sqarohet/theksohet, për të dhënë në përdorim prona të tjera që ju i dispononi si bashki jeni të lutur të zbatoni procedurat sipas Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, neni 4, germa b/v, në të cilën shprehet se ju detyrimisht duhet të depozitoni çertifikatën e pronësisë ose në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI


Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr 05 Datë 25.01 2023

**“Për miratimin në parim të listës së pasurive të llojit “Kullotë”, të gatshme për dhënie në përdorim”**

Në mbështetje të nenit 8, neni 9, pika 1.2, neni 27, pika 5, të ligjit nr 139/2015, “Për qeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr 8744 datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr 1, datë 09.06.2016, “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, ligji nr 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar, neni 17, “për përdorimin e sipërfaqes dhe të tokës fond kullosor”, si dhe pas Projekt Vendimit nr 1, datë 11.01.2023, paraqitur nga Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritit, sektori i Aseteve, ku propozohet “Për miratimin në parim të listës së pasurive të llojit Kullotë, të gatshme për dhënie në përdorim gjate vitit 2023”.

Pas shqyrtimit, diskutimit dhe miratimit, Këshilli Bashkiak Vau Dejës:

VENDOSI

1. Miratimin në parim të listës së pasurive të llojit “Kullotë”, të gatshme për dhënie në përdorim gjatw vitit 2023, sipas fletëve të inventarit bashkëlidhur, përkatësisht numrat rendorë në vijim: Nga nr 784-830 dhe 833-879.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritit
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, “Për qeverisjen vendore”, ndryshuar).

**KRYETAR**

Mark Bisha

Sekretar Keshillit Bashkiak  
Ardian Çelepija

Miratuar me 19

Vota Pro 19

Vota kunder -

Vota abstenim -

Zbardhur me 27.01.2023

